



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.6.2024, merr këtë

**V E N D I M**  
**P Ë R**  
**RIALOKIMIN E MJETEVE TË BARTURA NË VITIN 2024**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura nga të hyrat vetjake në vitin 2024, në shumë prej **11,189,095.12 €**.

**II.**

Qëllimi i Vendimit, si në pikën 1, është:

1. Rialokimi i mjeteve të bartura në vitin 2024, në shumë prej **11,189,095.12 €**.

**III.**

Rialokimi i mjeteve të bartura në vitin 2024, në kategorinë për investime kapitale:

- a) *Rialokimi në kategorinë e investimeve kapitale-300 sipas nënprogrameve .....* 11,189,095.12 €;

**Gjithsej: 11,189,095.12 €**

**IV.**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelore.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-400/03-83885/24, më 2.7.2024

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina



## Arsyetim

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësive dhe Ligjin mbi buxhetin, nr. 08/L-260, neni 16, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024, si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Dedikimi për rialokimin e mjeteve në kategorinë e investimeve kapitale, do të jetë për sigurimin e mjeteve për sigurimin dhe përfundimin e projekteve kapitale.

Të bashkëngjitura janë në forma tabelore.